



Nr. 1124 Prot

Datë, 23 . 01 . 2019

**NJOFTIM PËR VETËKANDIM PËR ANËTAR TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT
NË UNIVERSITETIN ISMAIL QEMALI, VLORE.**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Rregullores nr. 2459/1, datë 15.03.2016 "Për organizmin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.782, datë 26.12.2018 "Për caktimin e kriterëve dhe të procedurave për përzgjedhjes të anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për administrimin, në institucionet publike të arsimit të lartë" si dhe shkresën Nr.322, datë 14.01.2019 "Për zbatimin e vendimit Nr.782, datë 26.12.2018" të Ministrisë të Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Komisioni Institucional Zgjedhor, hap procedurën e kandimit për anëtar të Bordit të Administrimit të Universitetit Ismail Qemali, Vlorë.

Kriteret për t'u emëruar anëtar i bordit janë, si më poshtë vijon:

- a) Të ketë integritet etik dhe profesional;
- b) Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;
- c) Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- ç) Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesave.

Kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin e poshtë shënuar:

1. Kërkesa për vetëkandidim.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit.
3. Cv në modelin Europass.
4. Kopje e diplomave Universitare dhe pasuniversitare të fituara. Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e certifikatës së njohjes nga organi kompetent.
5. Dëshmi penaliteti.
6. Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria se nuk janë në ndjekje penale apo në proces gjyqësor penal.
7. Vetëdeklarim se nuk kanë konflikt interesi për pozicionin që kandidojnë.
8. Vetëdeklarim se nuk janë në konflikt gjyqësor me Universitetin Ismail Qemali, Vlorë.
9. Raport mjekësor për aftësinë në punë, lëshuar 3 muajt e fundit (origjinal);
10. Kopje e noterizuar e dëshmimeve, kualifikimeve dhe trajnimeve.

REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR



Kandidatët dokumentacionin duhet ta paraqesin shërbimit postar drejtuar në adresën:

**Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë,
Lagjja. "Pavarësia", Rr. "Kosova" 9400 Vlorë, Shqipëri.
Komisionit Institucional Zgjedhor të Universitetit Ismail Qemali.**

Mungesa e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për skualifikimin e kandidatit.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit për anëtarë të Bordit të Administrimit si përfaqësues i studentëve të Universitetit Ismail Qemali, Vlorë në datë *28.01.2019 deri më 09.02.2019*, prej orës 10.00 deri në orën 16.00.

KRYETAR I KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR
AULONA HAXHIRAJ